



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KRYETARI

Nr. Prot. 4020/1

Tiranë, më 9.9.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Z. FATMIR XHAFAJ
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
KUVENDI I SHQIPËRISË

TIRANË

I nderuar z. Xhafaj,

Në vijim të shkresës suaj nr. 3017 prot., datë 31.07.2024, lidhur me dërgimin e propozimeve për përfaqësues/ekspertë pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian", më lejoni t'ju paraqes qëndrimin institucional të Gjykatës së Lartë.

Pikësëpari, dëshiroj t'ju siguroj, Ju si kryetar i Komisionit të Posaçëm, si dhe të gjithë deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, se Gjykata e Lartë ka qenë dhe mbetet e angazhuar në çdo nismë që ndërmerret prej ligjvënësit, me qëllim thellimin e reformës në drejtësi të miratuar në 2016, si e vetmja reformë e shtetit demokratik shqiptar e mbështetur njëzëri nga deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, si dhe partnerët ndërkombëtarë që kanë asistuar dhe mbikëqyrur hartimin dhe zbatimin e saj prej vitesh.

Jemi të ndërgjegjshëm se reforma në drejtësi, megjithëse ka arritur rezultate pozitive, ka nevojë për nxitje dhe angazhim të mëtejshëm institucional nga organet e tre pushteteve, me qëllim përmbushjen me përgjegjësi të plotë të detyrimeve të tyre kushtetuese e ligjore. Për këtë arsye, ne besojmë se nisma e ndërmarrë nga Kuvendi, sipas objektit dhe rezultateve të pritshme të Komisionit të Posaçëm, me fokus thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin do të ndihmojë që reforma në drejtësi të vijojë suksesshëm kryerjen e misionit të saj.

Gjithashtu, ne besojmë fort se, në respekt të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe të mbrojtjes së pavarësisë së institucioneve, kjo nismë e Kuvendit, në kuadrin e gjithëpërfshirjes dhe transparencës, ka si parakushte për suksesin e saj konsensusin e gjerë për vendimmarrjen parlamentare dhe mbështetjen e drejtpërdrejtë të ekspertizës së partnerëve ndërkombëtarë, pa të cilët reforma në drejtësi e ndërmarrë në 2016 nuk do të kishte marrë jetë.

Së dyti, më lejoni t'Ju sjell në vëmendje pozicionin e veçantë që Gjykata e Lartë mban në arkitekturën e institucioneve publike në përgjithësi dhe në sistemin gjyqësor në veçanti, si dhe misionin kushtetues që ajo kryen. Duke mbajtur parasysh këtë funksion të Gjykatës së Lartë në raport me pushtetet e tjera, vlerësojmë se kërkesa Juaj për pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të gjyqtarëve të kësaj Gjykate si anëtarë të një nëngrupi teknik, në varësi të Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë të Komisionit të Posaçëm, që duhet të kryejnë detyrat e caktuara sipas vendimmarrjes së Komisionit, nuk përshtatet me funksionin dhe misionin e gjyqtarit. Si e tillë, nga ana jonë nuk vlerësohet si zgjidhje e përshtatshme në përmbushje të misionit të Komisionit të Posaçëm.

Sigurisht, Gjykata e Lartë mirëpret mundësinë për të dhënë opinione për projektligjet që lidhen drejtpërdrejtë me funksionin e saj. Me kënaqësi konstatojmë se praktika e viteve të fundit ka treguar se propozimet për disa ndryshime në ligjet procedurale civile, penale dhe administrative, me qëllim rritjen e efikasitetit të gjykimit dhe parandalimin e krijimit të stokut të ri, të miratuara nga Kuvendi me kontributin edhe të gjyqtarëve dhe këshilltarëve ligjorë të Gjykatës së Lartë (në mënyrë të pavarur dhe pa qenë pjesë e komisioneve apo nënkomisioneve të ngritura për këtë qëllim pranë Kuvendit), ka ndikuar pozitivisht në drejtim të shpejtësisë dhe cilësisë së gjykimit të rekurseve.

Së treti, duke mbajtur parasysh sa më sipër, si dhe duke vlerësuar nismën e Kuvendit në procesin e integritetit evropian të Shqipërisë, të ndërgjegjshëm se shteti i së drejtës është çështje që kërkon ndihmesën e të gjithë institucioneve publike, përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, jemi të gatshëm të ofrojmë kontributin tonë në këtë proces. Modalitetet e këtij angazhimi duhet të jenë të tilla që të pajtohen me pavarësinë dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor, si themeli i shtetit të së drejtës. Si e tillë konsiderohet dhënia e mendimeve dhe sugjerimeve lidhur me gjetjet që do të arrijë Komisioni i Posaçëm Parlamentar sa i takon nevojës për ndërhyrje institucionale dhe ligjore në sistemin e drejtësisë. Ky kontribut mund të jetë efektiv, duke i vënë në dispozicion Gjykatës së Lartë analizën e përgatitur nga ekspertët pranë Komisionit të Posaçëm, si dhe propozimet konkrete për ndërhyrje ligjore. Vetëm pas kësaj faze mund të përgatitet nga grupi i gjyqtarëve dhe këshilltarëve ligjorë pranë Gjykatës së Lartë një material i konsoliduar me sugjerime dhe propozime, të cilat mund të jenë me interes për Komisionin, me qëllim kthimin e tyre në akte ligjore.

Megjithatë, për të qenë pjesë e këtij procesi të rëndësishëm që ndikon në forcimin e shtetit të së drejtës dhe ndihmon në nxjerrjen e një produkti sa më cilësor nga ana e Komisionit të Posaçëm, Gjykata e Lartë, e përgjegjshme për misionin që i është caktuar, ka ngritur një grup pune të përbërë nga gjyqtarë dhe këshilltarë ligjorë, të cilët do të përgatisin materialin përkatës mbi problematikat e veprimtarisë së këtij institucioni dhe të sistemit të drejtësisë në përgjithësi, shoqëruar me propozime konkrete lidhur me masat ligjore dhe institucionale që duhen ndërmarrë.

Nga ana tjetër, për të qenë sa më të informuar mbi veprimtarinë e Komisionit të Posaçëm Parlamentar me qëllim marrjen dhe përcjelljen në kohë sa më të shpejtë të informacionit mbi problematikat që lidhen me mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë në përgjithësi dhe të Gjykatës së Lartë në veçanti, tre punonjës nga stafi i lartë teknik i këtij institucioni, konkretisht znj. Arta Vorpsi, Drejtore e Kabinetit të Kryetarit, z. Miran Kopani dhe znj. Bjorka Duka, këshilltarë ligjorë mund të marrin pjesë me cilësinë e vëzhguesit pranë Komisionit të Posaçëm.

Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj dhe në pritje të bashkëpunimit të mëtejshëm, në emër të Gjykatës së Lartë ritheksoj gatishmërinë për të mbështetur çdo nismë politike dhe institucionale, që

ka për qëllim të rrisë besimin e publikut tek sistemi gjyqësor dhe shpejtojë integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, bazuar në parimet dhe shtyllat themelore të mbrojtjes së pavarësisë së institucioneve, mbi të cilat u hartua reforma në drejtësi në 2016.

Me respekt,



KRYETARI

SOKOL SADUSHI



[shqiptarja.com]

Tel.: +355 4 2257304, Rruga: "Ibrahim Rugova" Tiranë.

E-mail: supremecourt@gjkataelarte.gov.al ; www.gjkataelarte.gov.al